

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

AUTORITETI I MBIQYRJES SË LOJRAVE TË FATIT

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
	23.01.2026	Kerkesë për informacion me nr.177 prot datë 23.01.2026 ku na kërkon informacion lidhur me procedurat që ka ndjekur AMLF për shpërdarjen e reklamave mashtruese në rrjetet sociale të ashtuquajtura “Kazino Online”		Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion me nr.177 prot datë 23.01.2025 ku na kërkon informacion lidhur me procedurat që ka ndjekur AMLF për shpërdarjen e reklamave mashtruese në rrjetet sociale të ashtuquajtura “Kazino Online” ju bëjmë me dije se: AMLF-ja pasi është njohur me fenomenin e reklamimit online të aktiviteteve në fushën e Lojrave të Fatit, duke përdorur emrat tregetar të subjekteve të licensuara në kategoritë “Kazino / Kazino të vendosura në hotele me 5 yje” ju është drejtuar me shkresë subjekteve të licencuar në fushën e lojërave të fatit në lidhje me reklamimin në rrjetet sociale. Në përgjigje të kërkesës për informacion nga AMLF, shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit janë shprehur se: Nuk kane bërë reklamim në rrjetet e tyre sociale për zhvillimin e aktivitetit të lojrave të fatit online por referuar rasteve të publikimit në rrjetet sociale të ashtuquajtura “Kazino Online” deklarojnë se janë palë të treta të pa identifikuar që përdorin emrin dhe imazhin e tyre. Në vazhdim AMLF – ja i është drejtuar institucioneve shtetërore “AKEP dhe Policisë së Shtetit” për të bërë të mundur mbylljen e këtyre faqeve pirate.	E plotë	Nuk ka

				Gjithashtu AMLF – ja ka bërë njoftim në web site-in e saj zyrtar dhe në rrjetin social Facebook për të mbrojtur lojtarët ndaj praktikave mashtruese dhe manipuluese në fushën e Lojrave të Fatit.		
	26.02.2026	Kërkesë për informacion datë 26.02.2026 ardhur me email në adresën e AMLF-së.		Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 26.02.2026 ardhur me email në adresën e AMLF-së (protokolluar me tonën me nr.576 prot datë 10.03.2026 ju bëjmë me dije si më poshtë: 1.Lidhur me pyetjen se cfarë kushtesh duhet të plotësojë një individ për të marrë pjesë në një shorte apo llotari? Në zbatim të VKM-së nr.196/2017 “Për përcaktimin e mënyrave, formave, kriterëve dhe rregullave për organizimin e Lojërave të fatit Promocinale”, bazuar në kreun i “Format dhe Rregullat për Organizimin e Lojërave të Fatit Promocionale” konkretisht në pikën 6 e cila përcakton se subjektet publike ose private mund të organizojnë lojë fati promocionale, vetëm pasi të jenë pajisur me autorizimin përkatës nga drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Bazuar në nenin 9 “Për marrjen e autorizimit, subjekti duhet të paraqesë pranë AMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm: a) Kërkesën me shkrim, ku të evidentohen të dhënat e subjektit, objekti i veprimtarisë së tij dhe një përshkrim i shkurtër i lojës, që do të organizohet;	E plotë	Nuk ka

				b) Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, ku të vërtetohet se shoqëria është me status aktiv; c) Vërtetim që shoqëria nuk është në procedura likuidimi dhe/ose falimentimi; ç) Certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit; d) Vërtetim nga organi tatimor për shlyerjen e detyrimeve tatimore; dh) Rregulloren në të cilën të jenë të parashikuara në mënyrë të detajuar mënyra e organizimit të lojës promovionale, kriteret që duhet të plotësojnë fituesit dhe çdo element tjetër që gjykohet i nevojshëm nga organizatori. 2.A kanë një afat licencat? Nëse po, cili është afati i përcaktuar? Bazuar në nenin 7 “Për lojërat e fatit promovionale jepet autorizimi i posaçëm. Autorizimi është i vlefshëm nga data e fillimit të lojës e cila nuk duhet të fillojë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së autorizimit dhe vlen vetëm për një lloj të caktuar loje promovionale. Afati që një subjekt mund të zhvillojë disa shorte promovional të percaktuara brenda një rregulloreje është 1 vit. Bazuar në nenin 11 “AMLF-ja merr në shqyrtim dhe vendos miratimin ose refuzimin e autorizimit brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës së subjektit pranë AMLF-së.		
--	--	--	--	---	--	--

			3.Sa llotari, shorte, giveaway do të kryejë çdo individ në një vit sipas detyrimit ligjor? Organizatori konkretisht subjektet publike apo private nuk kanë kufizime sa shorte promocional mund të kryejnë gjatë vitit por kanë kusht që për çdo organizim loje promocionale të përcaktohen qartë nga organizatori në rregulloren e lojës këto të dhëna të detyrueshme si më poshtë: a) llojin e lojës promocionale, që do të organizohet; b) kohëzgjatjen e lojës, sipas parashikimit të organizatorit; c) numrin dhe mënyrën e shpërblimit të fituesve; ç) vlerën monetare/çmimin, me dhe pa TVSH, që duhet të paguajë pjesëmarrësi në lojë, apo format e tjera të pagesës, në varësi të mënyrës së organizimit të lojës, në përputhje me përcaktimin e shkronjave “a” e “b”, të kësaj pike; d) çmimin/bonusin që ofron organizatori i lojës, të konvertuar edhe në vlerë monetare; dh) numrin e parashikuar të pjesëmarrësve në lojë; e) pjesëmarrësit që kanë të drejtë të marrin pjesë në lojë; ë) mënyrën e përzgjedhjes së fituesve dhe vendin ku do të bëhet përzgjedhja; f) mënyrën e njoftimit të fituesve; g) informacion të plotë dhe të saktë lidhur me mekanizmin e lojës promocionale\		
--	--	--	---	--	--

				Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit pasi miraton autorizimin për zhvillimin e shorteut ja përcjell organeve tatimore dhe bashkarisht mbikqyrin procesin në datën e caktuar nga organizatori. 4.Sa individë janë të autorizuar për të marrë pjesë në shorte, lotari, giveaway?Lutemi të na vendosni listën(emër mbiemër) të tyre? Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ka autorizuar 23 (njetetë e tre) subjekte tregëtare për të organizuar shorte promocial për periudhën Janar, Shkurt, Mars bazuar VKM-së nr.196/2017 “Për përcaktimin e mënyrave, formave, kritereve dhe rregullave për organizimin e Lojërave të fatit Promocinale” ku janë përfaqesuar nga punonjësit e autorizuar 33 (tridhjetë e tre) shorte pasi disa nga subjektet kanë zhvilluar më shumë se një shorte sipas parashikimeve në rregulloren e paraqitur. Lidhur me vendosjen në dispozicion të listës (emër, mbiemër) për subjektet e autorizuar për organizimin e shorteve promocial,ja u vendosim në dispozicion vetëm nëse subjekti (i autorizuar) mbajtës i të dhënave personale jep pëlqimin, bazuar në nenin 9 “Përpunimi i të dhënave personale” të ligjit Nr.124/2015 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” duke mos cënuar përhapjen ose aksesin e paautorizuar të dhënave personale të ruajtura, të transmetuara ose të përpunuara në ndonjë mënyrë tjetër.Nëse keni ndonjë emër konkret na dërgoni sërisht kërkesë për informacion të vazhdojmë me procedurat përkatëse.		
--	--	--	--	---	--	--

	18.03.2026	Kërkesë për informacion datë 18.03.2026 ardhur me email në adresën e AMLF-së (protokolluar me tonën me nr. 671 prot datë 24.03.2026		Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 18.03.2026 ardhur me email në adresën e AMLF-së (protokolluar me tonën me nr. 671 prot datë 24.03.2026 ju bëjmë me dije si më poshtë: 1.Sa operatorë kanë shprehur interesin për tu licencuar në fushën e lojërave të fatit dhe cilat kategori? Bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH” janë percaktuar “Kategoritë e lojërave të fatit” që lejohen të zhvillohen në RSH si mëposhtë: a) Baste sportive online; b) Kazino/kazino te vendosura ne hotele me 5 yje; c) Lojë elektronike ne distancë; d) Resort kazino; e) Lotari Kombëtare; f) Bingo televizive Bazuar në kriteret e licencimit, pranë AMLF-së kanë shprehur interes dhe rezultojnë të jenë licencuar në kategorinë “Kazino” 1 subjekt dhe në kategorinë “Kazino ne hotele me 5 Yje” 9 subjekte. 2.Pse nuk ka operatorë të licencuar për bastet online në Shqipëri, duke qenë se u miratua një ligj 2 vite më parë për këtë çështje? Ndërkohë, sa raste të tilla (online) keni referuar të Policia e Shtetit dhe AKEP?	E plotë	Nuk ka
--	------------	---	--	--	---------	--------

				Referuar ndryshimeve ligjore nr.18/2024, datë 15.02.2024 të ligjit nr. 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH”, aktualisht nuk janë licencuar ende operatorë për organizimin e basteve sportive online, pasi aktet nënligjore janë në proces miratimi, të cilat përcaktojnë kriteret dhe procedurën e licencimit për këtë kategori loje. AMLF bazuar në ndryshimet e ligjit në vitin 2019 konkretisht në nenin 57 “Bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore të ligjit nr. 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH” rastet e konstatuar që ushtrojnë aktivitet baste sportive online të pa pajisur me licencë i ka referuar pranë organeve të Policisë së Shtetit për vazhdimin e procedurave të metejshme hetimore pasi përbëjnë kundërvajtje penale bazuar në nenin 197 “Organizimi i palejuar i llotarive” dhe adresat ku ushtrohej ky aktivitet(domainet) si dhe ja ka derguar AKEP për mbylljen e tyre në teritorin e RSH. 3.Sa inspektive janë kryer nga AMLF për 2 vitet e fundit ndaj aktivitetit të paligjshëm të basteve/lojërave të fatit? AMLF gjatë 2 viteve të fundit ka kryer inspektive vetëm në raste të ankesave të ardhura nga qytetarët me shkresë pranë zyrave të institucionit ose ankesave të ardhura nga portal i bashkeqeverisjes si dhe me referim nga organet e tjera shtetërore ndaj aktivitetit të paligjshëm të basteve sportive online. Në të gjitha rastet konstatimet nga inspektimet e AMLF-së në zbatim të nenit 57 “Bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore të ligjit nr. 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH janë referuar pranë organeve të Policisë së Shtetit për të ndjekur procedurat e mëtejshme ligjore		
--	--	--	--	--	--	--

				bazuar në nenin 197 të Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”. 4.Sa masa administrative, gjoba apo kallëzime janë bërë nga AMLF për aktivitet të paligjshëm? AMLF-ja në cdo rast konstatimi të aktiviteteve të paligjshme në fushën e lojrave të fatit në zbatim të nenit 57 “Bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore të ligjit nr. 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH i ka referuar pranë organeve të Policisë së Shtetit për të ndjekur procedurat e metëjshme ligjore bazuar në nenin 197 të Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”. <i>Në cdo rast konstatimi i veprimtarive të palejuara në fushën e lojrave të fatit kur nuk përbën përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe ndiqet nga organet e procedimit penal. Të gjitha rastet e konstatuara përbëjnë veper penale dhe janë proceduar sipas legjislacionit në fuqi.</i> 5.Sa faqe interneti, domain-e ose adresa janë referuar për bllokim të AKEP për 2 vitet e fundit? AMLF ka referuar për bllokim pranë AKEP një numër të konsiderueshëm adresash (online) që dyshoheshin se ushtronin aktivitet të paligjshëm baste sportive online. Gjithashtu AMLF është në korespondencë të vazhdueshme me AKEP dhe sektorin e Krimit Kibernetik pranë Policisë së Shtetit mbi cdo rast konstatimi të adresave(online) ushtrimit të veprimtarisë së paligjshme baste sportive online. 6.A ka AMLF të dhëna mbi ankesat e qytetarëve për bastet të paligjshme, mosshlyerje detyrimesh, manipulime ose akses nga të miturit?		
--	--	--	--	--	--	--

				AMLF është treguar bashkëpunuese në cdo rast që ka pas ankesa nga qytetarët për baste sportive të paligjshme duke vepruar sipas procedurës me verifikimin e rastit, konstatimin nëse ka rezultuar se ushtron veprimtari të paligjshme në fushën e lojrave të fatit dhe referimin në organet e Policisë së Shtetit. Gjithashtu AMLF ka publikuar në faqen zyrtare (web), njoftime paralajmëruese për të gjithë qytetarët, të mos rënë pre e mashtrimeve mbi rastet e lojrave të fatit online të publikuara në internet. 7.Sa raste janë referuar të AIF, Policia ose Prokuroria për dyshime mbi pastrim parash ose përfshirje të krimit në këtë sektor. AMLF bazuar ne nenin 57 “Bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore” të ligjit nr. 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH” mbi rastet e konstatuara ka referuar pranë organeve të Policisë së Shtetit një numër të konsiderueshem individesh për të ndjekur procedurat e mëtejshme ligjore bazuar në nenin 197 të Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara” dhe vazhdimin procedimit pranë organeve hetimore si Prokuroria. Gjithashtu një numer të konsiderueshëm adresash (online) që dyshoheshin se ushtronin aktivitet të paligjshem baste sportive online i janë referuar AKEP për mbylljen e tyre.		
	22.01.2026	Kërkesë për informacion me nr		Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion me nr 202600123/2 prot datë 22.01.2026 dhe rregjistruar pranë AMLF mr nr.210 prot datë 28.01.2026 ku na	E plotë	Nuk ka

		202600123/2 prot datë 22.01.2026.		kërkoni informacion në lidhje me ankesën e shtetasit Don Murati, ju bëjmë me dije se: Nga verifikimet e kryera mbi regjistrin e kërkesave për ndalim hyrje në ambjentet e subjekteve të licencuara që ushtrojnë aktivitet “Lojra Fati” na rezulton se: Shtetasja Alma Murati me ID: I26130102F ka paraqitur kërkesën me Nr.2718 datë 29.12.2025 pranë AMLF-së për ndalimin e hyrjes te djalit te saj shtetasit Don Murati me ID K10714057J në ambjentet ku ushtrohet aktivitet Lojra Fati. Bazuar në pikën 4 neni 6 të ligjit 155/2015 “Për Lojrat e Fatit ne RSH” kërkesa për ndalim-hyrje është bërë nga një prej familjareve të shtetasit Don Murati dhe konkretisht nga nëna e tij, ku bashkëngjitur saj gjendet çertifikata familjare ku vertetohet marëdhënia midis tyre, një fotokopje e kartës së identitetit dhe një fotografi e kohëve të fundit të shtetasit Don Murati, për identifikim sa më të qartë. AMLF pasi shqyrtoi kërkesën e bërë nga familjarët e shtetasit Don Murati me ID: K10714057J, vlerësoi se kërkersa ishte brenda kriterëve të kuadrit ligjor dhe vendosi që ky shtetas të ndalohej për të hyrë në		
--	--	-----------------------------------	--	---	--	--

				ambjentet e subjekteve të licencuara në fushën e lojrave të fatit. Me shkresën Nr2718 datë 31.12.2025 AMLF njofton të gjitha subjektet e licencuara në fushën e lojrave të fatit të marri masa për ndalimin e këtij shtetasi në ambjentet e tyre bazuar në pikën 4 të nenit 6 të Ligjit Nr 155/2015 datë 21.12.2015 “Për lojrat e Fatit në RSH” ku përcaktohet se: <i>“Organizatori merr masa të ndalojë për të luajtur në mjediset e lojrave të fatit një person, për të cilin ka një kërkesë nga vetë lojtari apo prej të paktën një prej familjareve të tij, ku kërkohet moslejimi i këtij personi për të hyrë në mjediset e lojrave të fatit”</i>. Bashkëngjitur po ju vendosim në dispozicion një kopje të praktikës së ndjekur në lidhje me shtetasin Don Murati me ID: K10714057J për të cilin është vendosur ndalim- hyrja në ambjentet e lojrave të fatit bazuar në kërkesën e familjarëve të tij.		
	Datë 13.07.2026	Kërkesë për informacion: 1.A është plotësuar me akte nënligjore ligji 155/2015 “ Për lojrat e Fatit në		Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, bazuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” ju bëjmë me dije se: 1.A është plotësuar me akte nënligjore ligji 155/2015 “ Për lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)?	E plotë	Nuk ka

		Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)? 2.Kur priten të hapen aplikimet për licencat dhe sa do të zgjasë afati për të aplikuar?		Ligji 155/2015 “Për lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), me miratimet e fundit është plotësuar me aktet nenligjore përsa i përket kategorise së lojës “Baste Sportive online” ndërkohë priten të miratohen aktet e fundit nënligjore për kategorinë e lojes “Lotaria Kombëtare” etj. 2.Kur priten të hapen aplikimet për licencat dhe sa do të zgjasë afati për të aplikuar? Bazuar në nenin 4 dhe 5 të VKM-së nr.194, datë 26.03.2026 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, afateve, procedurës së konkurimit dhe metodologjisë së pikëzimit për dhënien e licencës për kategorinë e basteve sportive online” të cilat përcaktojnë rregullat e procedurës konkurruese, dhe njoftimin e thirjes për konkurim, ju informojmë si më poshtë: Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit (AMLF), Komisioni i Licencave i ngritur në bazë të nenit 17/1 të ligjit 155/2015 “Për lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe sekretariati teknik pranë tij organizojnë procedurat konkurruese dhe vlerësuese sipas detyrave përkatëse, të përcaktuara me ligj dhe në këtë vendim. Komisioni i licencave merr vendim për hapjen e një procedure konkurruese dhe numrin e licencave që do të jepen në thirje. Brenda 7(shtate) ditëve nga marrja e vendimit për hapjen e procedurës konkurruese nga Komisioni I Licencave, AMLF publikon njoftimin për konkurim për dhënien e licencës për ofrimin e “Basteve Sportive online” në faqen zyrtare të internetit, në dy gazeta ndërkombetare, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.		
--	--	---	--	--	--	--